Pml.nr.220/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi kryetar, Nesrin Lushta e Emine Kaçiku-anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit A. Rr. nga fshati N., komuna e K., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273.par.2.lidhur me nenin 31.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.184/18, të datës 29.01.2019, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.100/2019 të datës 30.04.2019, në seancën e mbajtur më 09.09.2019., mori këtë:

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit A. Rr., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.184/18, të datës 29.01.2019, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.100/2019, të datës 30.04.2019.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.184/18, të datës 29.01.2019, i dënuari A. Rr. është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273.par.2.lidhur me nenin 31.të KPK, në bashkëkryerje me të dënuarin I.Rr., dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh në të cilin i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 06.08.2018, deri në datën 29.01.2019, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 5.000 (pesëmijë) euro, të cilin është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit si dhe shumën prej 50 euro për kompensimin e viktimave të krimit. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues i konfiskimit të narkotikut “marihuanë” në peshë prej 19.370 gr. Automjeti në të cilin është gjetur narkotiku i është kthyer pronarit. I dënuari është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.100/2019 të datës 30.04.2019, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të dëmtuarve dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, mbrojtësi i të dënuarit, avokati Sh.P., nga Gj., ka paraqitur kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.155/19,të datës 16.08.2019, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendohet se aktgjykimet janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 12.të KPPK sepse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë, i pakuptueshëm, jo korrekt dhe jo në përputhje me arsyet e tij. Po ashtu pretendohet se nuk është bërë vlerësimi i provave kontradiktore konform dispozitës së nenit 361.të KPPK dhe nuk janë dhënë arsye për se gjykata njërës provë i ka besuar e tjetrës jo dhe konkludimet e veta nuk i ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme.

Duke mos shpjeguar se si këto të meta janë manifestuar, paraqitësi i kërkesës ka dhënë përmbajtjen e mbrojtjes së të dënuarit dhe të bashkë të akuzuarit I. Rr..

Gjykata Supreme konstatojë se nga aktgjykimet e kundërshtuara rezulton se gjykatat kanë konstatuar se në kohën kritike, pasi që policia ka qenë e informuar, te shtëpia e të dënuarve e kanë pritur ardhjen e të dënuarve dhe pasi që me automjet kanë ardhur të dy të dënuarit dhe bashkëshortja e të dënuarit A. Rr., një sasi të narkotikut e kanë gjetur në bagazhin e automjetit ndërsa sasinë tjetër në podrumin e shtëpisë dhe se policët Xh. H. dhe A. D., të dëgjuar në veti të dëshmitarëve kanë deklaruar se i dënuari A., e ka lënë qesen me narkotik në podrum. Përderisa i dënuari I. Rr., (babai i të dënuarit A.) ka pranuar të gjitha faktet relevante, ka mohuar se i dënuari A., ka ditur për praninë e narkotikut në bagazh dhe të ketë parë se ai ka ndërmarrë ndonjë veprim inkriminues, i dënuari A., Rr., ka mohuar ndërmarrjen e veprimeve inkriminuese. Në aktgjykimin e shkallës së parë është dhënë përmbajtja e secilës provë, ato janë vlerësuar në lidhjen njëra me tjetrën dhe është konkluduar se mbrojtja e të dënuarit nuk është argumentuar me deklaratat e dëshmitarëve e as me provat materiale me të cilat është vërtetuar lloji dhe sasia e narkotikut si dhe fakti se i dënuari e ka lënë qesen me narkotik në podrum, andaj se jo vetëm se e ka pasur në posedim, por ka tentuar ta fsheh. Dispozitivi i aktgjykimit së shkallës së parë është i qartë dhe

përmban një përshkrim ligjor për kohen dhe vendin e ngjarjes, veprimet konkrete e të dënuarit dhe detajet tjera të rëndësishme ndërsa në arsyetim, i cili është po ashtu i qartë, janë dhënë shpjegime për veprimet inkriminuese e të dënuarit dhe faktet tjera relevante për veprën penale dhe përgjegjësinë penale e të dënuarit.

Duke i kundërshtuar aktgjykimet për shkak të shkeljes së ligjit penal, mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë thekson se nuk është vërtetuar se ai e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor sepse aktgjykimi mbështet në dëshmi jo relevante, por as ky pretendim nuk u aprovua sepse që të dy aktgjykimet janë marrë me aplikimin e drejt të ligjit penal dhe me shpalljen fajtor e të dënuarit, në dëm të tij, ligji penal nuk është shkelur.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pml.nr. 220/2019, më 09.09.2019

Proçesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi